

*Vijojnë nga numri i kaluar*

**SHËNIME RRETH ÇËSHTJES VLLAHE.  
ÇËSHTJA VLLAHE DHE KONFERENCA E LONDRËS  
(Pjesa e dytë)**

Ministria e Punëve të Jashtme  
Relacion Shkëlqesisë së Tij, Ministrit

**Elementi rumun apo kuovllahët në Shqipëri dhe në Epir**

Duke shfrytëzuar rastin për sa referon konsulli mbretëror në Janinë në telegramin e tij të datës 5 në vijim n.190 zyra e quan me vend të përmbledhë shkurtimisht termat e çështjes rumune ose kuovllahe në Shqipëri dhe në Epir, së cilës ngjarjet e tanishme dhe pikërisht pjesëmarrja e Rumanisë në konfliktin evropian i kanë rikthyer karakterin aktual.

*Origjina e popullsisë kuco-vllehe Në Maqedoni, Shqipëri dhe Epir. Helenizëm dhe propagandë rumune. Apostull Margariti. Vendosja e fondeve të konsiderueshme në bilancin e Mbretërisë së Rumanisë për të ruajtur shkollat rumune të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Epirit. Qëndrimi i elementit kuovvlehh ndaj Italisë.*

Popullsitë rumune o vllahe o kuco-vllahe<sup>1</sup> (ky term i fundit është sajuar nga grekët dhe ka kuptim përbuzës) të shpërndara në Maqedoni, në Shqipëri dhe në Epirin e thirrur saktësisht ashtu, kanë të përbashkët me rumunët e Mbretërisë Rumune origjinën latine. E kanë prejardhjen nga legjionarët romakë që në kohën e Trojanit pushtuan Dacjen dhe gjithashtu në Epirin e poshtëm, nga legjionarët e ushtrisë së Pompeut të mbetur në vend pas betejës së Farsaljes.

Gjuha e folur nga kuovllahët me gjithë ndërfutjet e gjuhëve të tjera (sllave, turke, shqipe) në thelb është i njëjtë me atë që flitet nga rumunët e Rumanisë.

Studiuesit e çështjeve ballkanike janë përpjekur për ndarje të ndryshme dhe klasifikime të ndryshme të elementit vllah sipas vendeve të ndryshme të banuar prej tyre: vllahë të Pindit, vllahë të Olimpi, vllahë të Gramozit, vllahë farsaljotë, vllahë shqiptarë dhe të shqiptarizuar etj.etj. Pa u ndalur mbi gjithë këto ndarje dhe saktësime do të ndalemi veç në atë që tërë elementi vllah i shpërndarë në Maqedoni, Shqipëri dhe Epir jeton pjesërisht në gjendjen

---

<sup>1</sup> *Kuco* në greqishten moderne do të thotë *i çalë* dhe në kuptimin e figurshëm *i rremë, jo i vërtetë*, pra, vllahë të rremë (natyrisht për propagandën greke).

endacake (barinj të maleve të Gramozit, të Pindit etj.), pjesërisht gjendet e vendosur prej shekujsh në qendrat qytetare ku ushtron tregtinë, profesione liberale, industri të vogla shtëpiake etj.

Për shkak të faktit që elementi vllah, me përjashtim të pak bërthamave popullsia myslimane është krejt ortodokse dhe, pra, i nënshtrohet juridiksionit të Patriarkatit Ekumenik të Stambollit, kleri grek ka pasur në shekujt e kaluar lehtësi loje në punën e vet të helenizmit të kësaj gjindjeje latine, të rrjedhur drejtpërdrejtë nga pushtuesit romakë në Maqedoni dhe në Epir. E ka fajin propaganda greke nëse ndjenja e individualitetit të vet kombëtar mbeti në gjumë deri në gjysmën e shekullit të kaluar domethënë gjer kur nuk doli Apostull Margariti për t'iu kujtuar bashkëkombësve të vet origjinën e tyre të përbashkët me rumunët e Rumanisë dhe s'u bë flamurtar midis tyre të idesë së romanitetit dhe latinitetit. Apostull Margariti, lindur në fshatin e Avdelës në krahinën e Manastirit ishte vetë një vllah i greqizuar. Më 1865 u dërgua nga bashkëbesimtarët e vet në Bukuresht për të mbrojtur disa të drejta dhe interesa të manastireve greko-ortodokse të rajonit të vet.

Në Bukuresht u thellua në gjuhën rumune dhe u kthye në Maqedoni i shndërruar në mënyrë të tillë aq sa u bë një apostull i vërtetë i kombësisë vllahe apo rumune në vendet e gadishullit ballkanik që i ishin nënshtuar pushtimit turk.

Në sajë të tij lindën shkollat e para rumune në vilajetet e Selanikut, Manastirit, domethënë në Karaferis, Ngauste, Ohridë, Vllaho Klisura dhe Krusheva. Me të nisi propaganda rumune në Maqedoni, Shqipëri dhe Epir propagandë që u thellua gjithnjë e më tepër, e mbështetur gjerësisht dhe e financuar nga qeveria e Bukureshtit. Në vitin 1906 kur i nënshtrohet gjendej në Maqedoni thuhej se qeveria rumune kishte caktuar në bilancin e vet më shumë se gjysmë milion franga në vit për të mbajtur shkollat vllahë në Maqedoni, në Epir dhe në Shqipëri. Shtonin se për sakrifica të tilla në para qeveria e Bukureshtit nxitej jo vetëm nga arsye të kulluara ideale, domethënë për ta ruajtur gjuhën dhe kulturën rumune në pak ishujt me kulturë vllahe të mbijetuara në ato krahina, pas pushtimeve të vazhdueshme dhe shtrirjeve të popujve bullgarë, serbë, greko-shqiptare dhe turq, po edhe nga synimi për t'i krijuar vetes sido që të ishte disa të drejta në Maqedoni që t'ia paraqiste Bullgarisë për të fituar prej saj një ndreqje të kufirit nga ana e Dobruhës po që se Maqedonia do të binte nën pushtimin bullgar.

Në statistikat e botuara në Rumani të gjithë vllahët që banonin jashtë kufijve të Mbretërisë, domethënë në Maqedoni, në Epir dhe në Greqi (duke përfshirë në këtë Epirin grek) arrijnë shifra që lëvizin nga një milion e një qind mijë te një milion e gjysmë shpirta<sup>2</sup>. Këto shifra natyrisht janë shumë të ekzagjeruara. Megjithatë bindja e përbashkët e tërë shkrimtarëve të paanshëm

<sup>2</sup> Le të shihet si shembull statistika e zotit Bolintinuani.

që nuk verbohën në llogaritjet dhe gjykimet e tyre nga synime propagande dhe prozelitizmi është që tërë vllhët a rumunët që banojnë jashtë territorit të Rumanisë dhe pikërisht në krahinat e përmendura më lart, tejkalon me siguri gjysmë milion shpirtra.

Numri i vllhëve që jetojnë në territor shqiptar kuptoj për territor shqiptar atë të Shqipërisë politike sipas kufijve që i janë caktuar nga Konferenca e Londrës më 1913 dhe nga protokollit i Firences, jo territorin, shumë më të gjerë, të Shqipërisë etnografike – mund, sipas mendimit tim, të llogaritet me një shifër që lëkundet midis pesëdhjetëmijëve dhe gjashtëdhjetëmijë shpirtrave. Në Shqipëri, bërthamat më të fuqishme të popullsisë vllahe, gjenden në Shqipërinë e Mesme dhe në Shqipërinë e Jugut. Në Shqipërinë e Mesme bërthama më e rëndësishme është ajo e Elbasanit (gati gjashtëmijë shpirtra).

Sipas llogaritjesh të përafërta, mund të llogaritet mbi tridhjetëmijë shpirtra numri i vllhëve të vendosur në Shqipërinë e Jugut dhe d.m.th. gati njëzet mijë në sanxhakun e Beratit (që përfshin rajonet e Vlorës, Beratit, Lushnjës, Skraparit), kusuri në Epirin e Veriut, tashmë të pushtuar nga grekët. Në sanxhakun e Beratit dy qendrat më të mëdha me popullsi vllahe janë Berati (gati pesëmijë shpirtra) dhe Fieri (gati dymijë shpirtra). Në Epirin e Veriut të pushtuar nga grekët bërthamat më të fuqishme me popullsi vllahe gjenden në krahinën e Korçës dhe pikërisht në fshatin e [Moskopolit] dhe në rrethe. Për tërë shekullin e tetëmbëdhjetë, pikërisht në saje të popullsisë vllahe të vendosur atje. Moskopolit (Voskopoja) ishte mbase qendra më e lulëzuar tregtare në Epir dhe numëronte gati gjashtëdhjetëmijë banorë. Nga fundi i atij shekulli i famshmi Ali pashë Tepelena, pashai i egër i Janinës, shkatërroi atë qytet të lulëzuar popullsi e të cilit u shpërnda në pjesën më të madhe në krahina të tjera të Perandorisë Otomane dhe emigroi jashtë).

Si do të thuhet më vonë, vllhët e pjesës më të madhe të vendbanimeve të përmendura në telegramin e Konsullit Mbretëror në Janinë s'bëjnë pjesë në Shqipëri siç e ka krijuar Konferenca e Londrës, duke përfshirë në të pjesën më jugore e njohur me emrin Epir i Veriut tashmë e pushtuar nga grekët. Tërë këto vise, duke përjashtuar Korçën dhe Zagbianin janë ndarë nga Shqipëria dhe bëjnë pjesë tek Epiri i quajtur më pak a më shumë saktësisht Epir grek që u atrivua në fakt Greqisë në saje të traktatit të Bukureshtit të 1913-ës.

I përfundoj këto pak të dhëna mbi popullsinë vllahe në Shqipëri dhe në Epir duke përmendur që ajo, duke përjashtuar elementët filogreke apo të fituar nga propaganda greke ka shfaqur gjithnjë, duke kujtuar origjinën e përbashkët latine dhe duke qenë e vetëdijshme për marrëdhëniet e një miqësie të fortë ekzistuese në mes të Italisë dhe mbretërisë të Rumanisë, ndjenja simpatie shumë të gjalla për vendin tonë. Për këtë mund të dëshmojnë tërë agjentët e Mbretërisë që kanë shërbyer në Maqedoni dhe në Shqipëri.

Kur Italia në dhjetorin e 1914-ës po pushtonte Vlorën, ky afirmim i vendit tonë si fuqi ballkanike u përshëndet me entuziazëm jo vetëm nga shtypi i pavarur i Rumanisë po edhe nga kolonitë vllehe të vetë Epirit.

Lidhur me këtë çështje Konsulli Mbretëror në janinë shkruante sa vijon: (Raport i 15 shkurtit 1915, nr. 82, 11):

“Pushtimi italian i Vlorës ka bërë përshtypjen më të mirë dhe ka shkaktuar një kënaqësi të sinqertë në elementin vllah të shpërndarë në Shqipërinë e Jugut deri në shpatet e Pindit.

“Një dëshirë e zjarrtë e këtij elementi do të ishte ta shikonte pushtimin tonë të shtrihej deri në territoret e caktuara Shqipërisë dhe të banuar prej tij duke dyshuar se për shkak të vështirësive të brendshme tepër të rënda, shteti shqiptar s’do të mund të mbijetojë.

Vllehët që banojnë në zonën e cila tani pranohet pa dyshim si greke dhe saktësisht ata që janë më afër Pindit, janë të ndërgjegjshëm për pothuajse pamundësinë e Italisë të pushtojë territorin e tyre. Megjithatë duke supozuar që më vonë në fakt do të mund të ndodhë një shtrirje të sundimit italian në Shqipërinë e Jugut, ata mendojnë se prania jonë e afërt do të mund të kishte si pasojë propagandimin e kulturës sonë, të gjuhës sonë midis tyre, qofshin ata edhe të nënshtruar ndaj Greqisë, duke u asimiluar tërthorazi kështu nga ne nga pikëpamja intelektuale dhe gjuhësore.

Sipas kuco-vllehëve Italia do të duhej të arrinte gjer në Korçë, qendër kjo me të cilën lidhen bashkësi të shumta dhe të rëndësishme rumune. Për të arritur në Korçë dhe për të rrokur më mirë bërthamat vllehe të shpërndara edhe në Shqipërinë e Mesme, pushtimi ynë do të duhej të përfshinte edhe Elbasanin deri në bregun perëndimor të liqeneve të Ohrit dhe të Prespës duke arritur në jugë, pas Korçës, deri në vargmalet e Gramozit ku ekzistojnë shumë fshatra vllahe. “Duke lënë mënjanë mundësinë që pushtimi ynë të mund të arrijë në pikat e sapopërmendura, është fakt dhe pikërisht këtë mendoj se është me vend ta sinjalizoj, që tërë elementi rumun i Shqipërisë së Jugut është plotësisht pro nesh dhe s’do të dëshironte tjetër gjë veçse që pushtimi helen të zëvendësohej me atë italian.

“Motivi kryesor i kësaj gjendjeje shpirtërore e ka burimin te mënyra brutale dhe çnjerëzore me të cilën Greqia përpiqet me çfarëdo mjeti të kombëtarizojë popullsitë rumune që varen prej saj. Nëse vrasjet e rumunëve nga ana e çetave greke s’janë më në rend të ditës, si në kohën e pushtimit turk, meqenëse pas pushtimit helen këto çeta janë shpërndarë, s’është shuar armiqësia e shurdhët, e vazhdueshme e qeverisë dhe autoriteteve greke kundrejt elementit vllah, armiqësi që shfaqet në arrestime arbitrare, në pengesa të çfarëdolloji që i kundërvihen funksionimit të shkollave rumune, në nxitjen e elementit grek me urrejtjen, qoftë kundër atyre shkollave, qoftë kundër kishave rumune, priftërinjve e të cilave janë vënë në shenjë të veprimeve arbitrare dhe persekutimeve të autoriteteve dhe bashkësive helene.

Dhe të gjitha këto [ngjasin] me gjithë marrëveshjet e qarta dhe garancitë e nënshkuara në Traktatin e Bukureshtit midis Rumanisë dhe Greqisë, në favor të elementit rumun që varet nga kjo e fundit”.

Që ndjenjat e vllëhëve lidhur me vendin tonë s’janë dobësuar, po që madje, nën nxitjen e ngjarjeve janë shndërruar në një thirrje të vërtetë për mbështetje dhe ndihmë drejtuar Italisë, tani vërtetohet në mënyrë kuptimplote nga çka referon vetë Konsulli Mbretëror i Janinës në telegramin e datës 5 në vijim.

-----

Lidhur me përmbajtjen e këtij telegrami Zyra duhet të parashtrojë paralajmërimet që vijojnë:

1. që të gjitha viset e përmendura aty, me përjashtim vetëm të Korçës dhe të Zagbianit që gjenden në Epirin e Veriut, të pushtuar përkohësisht nga grekët, po që i përket Shqipërisë, ndodhen në Epirin grek, që u atribua Greqisë në bazë të traktatit të Bukureshtit (Në bazë të këtij Traktati Greqia, duke e shtrirë sundimin e vet në tërë ish-sanxhakun e Janinës, në pjesën më të madhe të ish-vilajetit të Selanikut dhe në një pjesë të madhe të vilajetit të manastirit, ka shtuar numrin e nënshtetasve të vet me kombësi vllahe me jo më pak se pesëdhjetëmijë a gjashtëdhjetëmijë shpirtra.

2. që Zyra sigurisht s’ka elemente për të gjykuar mbi mundësinë apo dobinë, qoftë nga pikëpamja politike dhe diplomatike, qoftë nga ajo ushtarake, për të realizuar dëshirat e shprehura nga popullsitë vllahe të Abdelës, Breasës, Samarinës, Zagorisë të cilat sipas asaj që rrëfen konsulli mbretëror në janinë, do të dëshëronin me zjarr që territori i tyre të pushtohej nga trupat italiane.

3. që, sa për kërkesën e drejtuar nga vllëhët e Epirit Konsullit Mbretëror në Janinë, për të marrë kombësinë italiane, Zyra nuk sheh, pavarësisht nga çdo konsideratë tjetër, mundësinë juridike për ta plotësuar.

Pasi i ka parashtruar këto paralajmërimet, Zyra i lejon vetes megjithatë të shprehë mendimin që pjesëmarrja e Rumanisë në luftën e madhe evropiane ka krijuar në një farë mënyre një situatë të re edhe lidhur me çështjen kucovllahe në Maqedoni dhe në Epir.

Duhet menduar se politika rumune ka për synim të përfitojë nga rastet që do t’i japë situata ushtarake gjithnjë e më e favorshme për aleatët, që të shohë përmirësimin e fateve të popullsisë të racës rumune në ato krahuina. Dhe duket qartë për Zyrën interesi që do të kishte vendi ynë që të mbështeste çfarëdo veprimi të qeverisë rumune të drejtuar në synimin e lartpërmendur. Nga tërë kjo, natyrisht, rrjedh që çfarëdo mase do të donim të merrnim në bazë të situatës së sinjalizuar nga konsulli mbretëror në Janinë s’do të mund ta merrnim veçse me pranimin dhe mbështetjen e qeverisë rumune.

Për sa u përket vllëhëve të Epirit e vlen të kujtojmë këtu në vijim shkurtazi aktet e fundit ndërkombëtare që lidhen me këtë çështje të rëndësishme:

Siç vihet re nga procesverbalet e Konferencës së Londrës më 1913 u vendos në të, sipas propozimit të zotit Eduard Grey që garancitë që do t'u jepeshin popullsisë kuco-vllehe që në përcaktimin e kufijve jugorë të Shqipërisë do t'i mbeteshin Greqisë do të përbënin objektin "d'une entente directe entre la Grece et la Roumanie"<sup>3</sup>.

Garancitë e lartpërmendura nuk u shënuan në traktatin e paqes së Bukureshtit, po rezultojnë nga shkëmbimi i poshtëshënuar i notave midis zotit Maioresco dhe zotit Venizelos që ishin në atë kohë përkatësisht Kryetar i Këshillit të Ministrave Rumun dhe i Këshillit të Ministrave Grek:

"Son Excellence Monsieur E. Venizelos, Président du Conseil des Ministres se Grece, Premier Délégué du Gouvernement Royal Hellénique à la Conférence de Bucarest.

Bucarest le 23 Juillet (5 aout) 1913

N. 17.277

Monsieur le Président du Conseil,

(Signe) T.Maioresco

.....

Shkëlqesisë së Tij Zotit Venizelos,

Kryetar i Ministrave të Greqisë,

Delegat i Parë i Qeverisë Mbretërore Helene në Konferencën e Bukureshtit

Bukuresht, 23 korrik (5 gusht) 1913

N. 17. 277

Zoti Kryetar i Këshillit,

Ashtu si jemi marrë vesh ne në rrjedhën e bisedave tona kam nderin t'i lutem Shkëlqesisë Suaj që të më konfirmojë si përgjigje e notës së tanishme që:

Greqia pranon t'u japë autonominë shkollave dhe kishave të kuco-vllehëve që gjenden në zonat që do të sundohen në të ardhmen nga grekët dhe që ta lejojë krijimin e një peshkopate për këta të lartpërmendur kuco-vllehë, me mundësinë e subvencionimit nga ana e qeverisë rumune, nën mbikëqyrjen e qeverisë helene, të të lartpërmendurave institucione aktuale dhe të ardhshme.

Pranoni, ju lutem etj.

(Nënshkruar): T.Maioresco

Son

.....

(Signe) E.K. Veniselos

<sup>3</sup> E një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë.

Shkëlqesisë së Tij Zotit T.Maioresco  
Kryetar i Këshillit të Ministrave  
Ministër i Punëve të Jashtme të Rumanisë

Bukuresht, 23 korrik (5 gusht) 1913

Zoti Kryetar i Këshillit

Si përgjigje ndaj notës, datuar këtë ditë, që Shkëlqesia Juaj ka dashur të më dorëzojë kam nderin t' i konfirmoj Shkëlqesisë Suaj që:

Greqia pranon t' u japë autonominë kishave dhe shkollave të kuco-vllehëve që gjenden në zonat që do të sundohen në të ardhmen nga grekët dhe që të lejojë krijimin e një peshkopate për këta të lartpërmendur kucovllahë, me mundësinë e subvencionimit nga ana e qeverisë rumune, nën mbikëqyrjen e qeverisë helene, të lartpërmendurave institucione aktuale dhe të ardhme.

Pranoni ju lutem, etj.

(Nënshkruar) E.K.Venizelos

Romë, 8 shtator 1919

G.Manzoni (Manzoni)

(duke i dhënë pjesën që i takon përgatitësit që është kavalier Stranieri)

Ministria e Punëve të Jashtme

Drejtor i Përgjithshëm I çështjeve politike 6/9

Stranieri,

Ju lutem më përgatisni, një relacion të shkurtër, po të plotë, mbi elementin kuco-vlleh, mbi prirjet kombëtare dhe politike të tij, rëndësinë e tij, ekzistencën e tij në krahinën shqiptare.

Për sa i përket telegramit që bashkëngjitet këtu, duhet nxjerrë një përfundim, duke treguar mundësinë për të vepruar në marrëveshje me qeverinë rumune.

G.M.

**Burimi:** *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2899-2914)

\*

\* \*

I parë

Telegram i arritur për Kryetarin e Zyrës së Shifrës

Vanuteli

I deshifruar nga Brigati Xhusto

Nr. 3886  
Konsullatë e Janinës  
Kopja nr. 7

Janinë, 5 shtator 1916, ora 20  
Romë, 5 shtator ora 14

Përparimi i italianëve në Epirin e Veriut ka shkaktuar një kënaqësi të madhe edhe midis elementit kuco-vlleh, zona e Korçës, Zagbianit, Grebenolit dhe Pindit. Konfirmoj lidhur me këtë atë që shkruaja në raportin nr.11 të 15 shkurtit 1916 për sa u përket ndjenjave të vlllehëve ndaj nesh.

Banorët e fshatrave të mëdhenj të Abelës – Shazës – Brazës – Samarisë, Perivolit, krahinës së Zagorisë dhe ? Brebena më bëjnë të njohur që do të dëshironin me zjarr që t'i shihnin të pushtuar fshatrat e tyre nga trupat italiane.

Kjo aspiratë është e përbashkët për tërë kuco-vllehët të zonave të përmendura në fillim. Banorët e fshatrave të lartpërmendur më bënë edhe kërkesën a është e mundur që ata të marrin kombësinë italiane.

Po të kishte ndonjë mënyrë për ta plotësuar këtë kërkesë, depërtimi ynë politik-intelektual në territoret e banuara nga vlllehët mund të quhej në përparim. Do t'i lutesha Shkëlqesisë Suaj ta shqyrtonte çështjen dhe t'ia komunikonte Legatës Mbretërore.

Nuvolari

**Burimi:** *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2914)

\*

\* \*

Komanda e XVI Korparmatës

Zonë lufte më 10 mars 1918

Qendra e Informacionit të Janinës telegrafon:

199 Më sigurojnë se disa kryetarë bandash gjenden në Janinë pa dallim monarkistësh dhe venizelistësh. Kanë qenë ftuar për të qenë gati për të formuar, po ta kërkojë rasti, banda për të cilat këtu nuk njihet synimi i saktë. Gjatë pritjes ndërkaq u jepet të lartpërmendurve kryetarë të bandave një çek mujor prej pesëdhjetë dhrahmive që do të shtohen kur të krijohen bandat në fjalë. Nëse, siç mendohet, ky lajm është i vërtetë, nuk përjashtohet që bandat të caktohen një ditë për të vepruar në dëmin tonë. Rezervohem për komunikime të mëvonshme.

Komunikim Athinë – Vlorë.

-----

202 Një burim i denjë për besim më siguron që kryetarët e bandave për të cilat flas në telegramin tim 199 do ta kenë marrë tani detyrën për të rekrutuar njerëz për të formuar banda. Propaganda për një rekrutim të tillë duket se bëhet edhe në territorin e okupuar nga Italia. Midis kryetarëve të bandave gjendet edhe Josifi nga Stibeci (Përmeti) që ndodhet këtu prej një farë kohe.

Vazhdojnë arrestimet dhe dërgimet në Janinë të të pabindurve të çamërisë dhe Pindit. Këto ditë të shoqëruar nga xhandarë kanë ardhur të pabindur nga Filiatea dhe Briaza. Këta të fundit duket se janë keqtrajtuar dhe rrahur.

Komunikim Vlorë-Athinë.

-----

### **201. Përmbledhje për situatën dhe përshtypje**

Rezervistët që i janë përgjigjur thirrjes janë gati 4500. Disa grupe po vijnë ende çdo ditë, si është sinjalizuar. Shumë janë paraqitur nga frika e reprezaljeve ndaj familjeve apo se janë gjurmuar dhe arrestuar nga detashmente ushtarësh, xhandarësh dhe bandash. Kjo ngjan veçanërisht në çamëri. Elementi vllah në krahinën e Pindit është veçanërisht kundërshtues për mobilizimin dhe duket i vendosur për të mos u paraqitur. Sidoqoftë s'ka dyshim se paraqitja e rezervistëve s'është spontane dhe, në kundërshtim me çka na sigurojnë gazetat greke nuk vihet re kurrfarë entuziazëm midis rezervistëve.

Popullsia është indiferente. Duket qartë se qeveria greke dhe gjithë autoritetet bëjnë çdo përpjekje për t'i dhënë një drejtim të ri frymës publike, po s'mund të besohet se shpirti i kombit të mund të ndryshojë për një kohë të shkurtër.

Greqia është dhe mbetet gjermanofile dhe kundër luftës sidomos tani që Rusia është shtërnguar për një paqe pa kushte dhe Rumania është gati për të pësuar të njëjtin fat. Në rast se do të mund të arrihet një rezultat i çastit do të jetë i përkohshëm dhe do t'i bëjë më të rënda pasojat e ardhshme.

Të gjithë dinë dhe thonë se Anglia dhe Franca, sidomos kjo e fundit, s'do të lenë pas dore asgjë për ta arritur mobilizimin, jo se presin ndonjë ndihmë të efektshme nga ushtria greke, po për t'i favorizuar aq sa është e mundur aspiratat helene. S'është në kompetencën time të gjykoj se deri në ç'pikë këto mund të kundërshtojnë interesat tona, mbetem megjithatë fuqimisht i bindur që po ta shohësh nga pikëpamja jonë, ndërhyrja e Greqisë jo vetëm s'do të jetë e dobishme, po madje e rrezikshme, sidomos nëse trupat greke, siç është përhapur një zë, do të jenë të destinuara të veprojnë për bri trupave italiane në Shqipëri.

Thuhet me shumë insistim [se kjo do të bëhet] në sektorin e Korçës. Sidoqoftë operacionet e mobilizimit zhvillohen shumë ngadalë dhe, megjithëse janë sinjalizuar ardhje të shpeshta të rezervistëve e të materialit luftarak është e vështirë të arrijnë në Janinë për shkak të mungesës së mjeteve të transportit. Më

duket e vështirë të vihet në efikasitet të plotë qoftë edhe një divizion i vetëm ushtarak. Morali i trupës në përgjithësi është i ulët, nënoficerët dhe oficerët përbëjnë në shumicën e tyre elementët më të pasigurtë të ushtrisë greke. Si shembull tregohen si monarkistë zyrtarë oficerët e Regjimentit të 25 të këmbësisë të Janinës dhe si i pasigurt tërë Regjimenti i 24 i këmbësisë së Prevezës. Gjenerali Miljotis donte të shpallte shtetrrëthimin e Epirit, po komisari grek e kundërshtoi, duke e quajtur pa vend, ndonëse nuk përjashtonte në mënyrë absolute që edhe këtu rendi publik gjatë mobilizimit mund të turbullohet. S'do të rri pa sinjalizuar çdo gjë të denjë për t'u vënë re.

Komunikimi Vlorë-Athinë

-----

205. Agjenti konsullor i Prevezës komunikoi në shtatë të muajit në vazhdim se edhe atje është shfaqur tifoja ekzantematike në trupë. Gjer tani janë vërtetuar dy raste. Partia e Venizellosit në Prevezë përhap zërin që divizioni i tetë ushtarak sapo të jetë mobilizuar do të çohet në Gjirokastër.

Komunikim Vlorë-Athinë

206. Agjenti konsullor në Prevezë komunikoi në datën 5 të muajit në vazhdim që meqenëse u këndua në një kompani të regjimentit të 24 të këmbësisë hymni i mbretit Konstandin u dënuan rreptë kapiteni, komandanti i kompanisë, katër rreshterë dhe tetë ushtarë. Dy rreshterë të lartë u ulën në grada tërë regjimenti i këmbësisë duke përfshirë oficerët me ndjenja monarkiste dhe kundër lufte.

Komunikimi Vlorë-Athinë.

**Burimi:** *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 1* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, imz. 4833-4834)

\*

\* \*

Konsullatë Mbretërore e Përgjithshme e Italisë në Janinë  
Për shikim Shkëlqesisë së Tij Ministrisë

Janinë, 29 qershor 1917

Nr. 1286

Vula e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Nr. 050936

28 korrik 1917

Objekt

Pushtimi ushtarak italian në krahinat e Janinës, Zagoroisë, Pindit, Çamërisë dhe problemet kryesore që rrjedhin së andjemi

## 2018/ Stranieri falënderojmë për raportin interesant

Si pasojë e pushtimit ushtarak të Janinës dhe të një pjese të rajonit omonim si edhe të pushtimit të krahinave të Zagorisë, Pindit dhe të Çamërisë, besoj se është me vend të parashtrij disa të dhëna dhe konsiderata që do të mund të japin një element të dobishëm për të gjykuar dhe për të vendosur se cila do të ishte vija e qëndrimit politik për t'u ndjekur dhe cili do të ishte veprimi që autoritetet tona ushtarake do të zbatonin mbi qeverinë e vendit qoftë në interesin tonë sa në interesin e popullsisë vendase.

Shkëlqesisë së Tij,  
Ministrit Mbretëror të Punëve të Jashtme  
Romë

Parashtrij disa të dhëna statistike mbi numrin e banorëve të provincës së Janinës me referim të veçantë për rrethet e përfshirë në juridiksionin e komisariatit ushtarak për Punët Qytetare të Janinës duke menduar se kjo mund të vlejë në fazën e parë të veprimit të komisariatit në fjalë, fazë që natyrisht është me karakter orientues.

Filloj nga provinca e vërtetë e Janinës sipas ndarjes administrative greke.

Provinca e cituar - seli prefekturë dhe që në epokën e pushtimit otoman i përgjigjej asaj që quhej "kaza" ndahet si vijon:

Janinë, qytet,	banorë	19,974
Zagori	banorë	19,112
Kurenda	"	26, 610
Malakashi	"	20.478
Çarkovista	"	14.823
E tëra		100,997

Te 19.974 banorët e Janinës përfshihen 15.571 ortodoksë (nga të cilët 1200 vllahë grekomanë), 1700 hebrenj dhe 1703 myslimanë.

Këta të fundit banojnë të gjithë në qytet: prej tyre 1.176 janë të lindur në Janinë ndërsa 528 janë emigrantë nga Shqipëria e Jugut dhe sidomos nga Leskoviku, Erseka dhe Gjirokastra, vise që ata i braktisën në epokën e trishtë të qeverisë së përkohshme epirote (vitet 1913-1914) që shkatërroi, me përjashtim të pak qendrave kryesore Epirin e Veriut, me synim për ta ndryshuar fizionominë etnike të vendit duke zhdukur elementin mysliman që përbënte shumicën e popullsisë për t'i pasur argumente që të mbështetej teza që karakteri etnik dhe gjuhësor i Epirit të Veriut ishte helen.

Në varësi administrative nga ish Prefektura greke e Janinës ishin vënë nënprefekturat e mëposhtme:

Mecova

Konica  
Pogoni  
Filiatesi  
Paratia (Aidonati)

Nënprefektura e Margaritit që tani përfshihet në rrethin e Komisarit për Punët Qytetare të Janinës varej përkundrazi administrativisht nga prefektura e Prevezës.

Pasqyra statistike e kopjuar këtu shënon numrin dhe ndarjen e banorëve të gjashtë prefekturave të lartpërmendura nga pikëpamja etnike, fetare dhe gjuhësore.

Nga nënprefektura	Shqiptarë myslimanë	Shqiptarë ortodoksë	Grekë ortodoksë	Vllehë	Izraelitë	Ciganë	Gjithsej
Janinë (kaza)	1703	...	70220	6400	2700	...	812023
Mecovë	...	...	850	4700	50	...	5600
Konicë	1200	...	12600	4000	...	200	18.000
Pogoni	1000	2000	16000	2500	...	400	21900
Filiates	12000	9000	6000	1000	...	...	28000
Paramithia	5000	5000	5000	...	...	800	15800
Margariti	16330	7100	200	30	64	50	24224
	<b>37.233</b>	<b>23.100</b>	<b>110,870</b>	<b>18.630</b>	<b>1.764</b>	<b>1950</b>	<b>194.547</b>

Në tërësi pra popullsia banuese në territoret e juridiksionit të komisaritit aktual ushtarak për Punët Qytetare të Janinës është 194.547 banorë.

Me përjashtim të të dhënave statistike lidhur me Janinën si qytet dhe rrethet e Zagorisë, Kurandës, Malakashisë, Arkovistës, të dhëna që janë mbledhur tani vonë nga kjo bashki dhe kam arsye të besoj se janë të sakta, të tjerat, të lidhura me nënprefekturat e Mecovës, Konicës, Pogonit, Filiatesit, Paramithiasë (Aidonat) dhe Margaritit janë mbledhur nga konsullata e Austro-Hungarisë e Janinës në vitin 1903 si rezulton nga tabela statistike e bashkëngjitur (Fletë e bashkëngjitur Nr.1) që tregon ndarjen e popullsisë të vilajetit të Janinës sipas kombësive dhe feve.

Pikërisht ngaqë janë komplikuar nga Konsullata e lartpërmendur në vitin 1903 (domethënë në kohën që zgjaste ende sundimi otoman) statistikat që përmbahen në fletën e bashkëngjitur nr. 1 mund të quhen si të paanshme dhe në parim të sakta. Po ta kërkojë rasti, Qeveria Mbretërore mund të mbështetet në to për të treguar në Konferencën e Paqes cili është në fakt karakteri etnik i territoreve të Epirit të Sipërm dhe të çamërisë.

Përsa u përket krahinave vllahe të Zagorisë dhe të Pindit bashkëngjis statistika të veçuara. Qeveria Otomane në vitin 1895 ka bërë një regjistrim të popullsisë së Vilajetit të Janinës duke botuar të dhënat e mbledhura në vjetarin e Perandorisë së po atij viti. Fleta e bashkëngjitur e shënuar me Nr. 2 përmban

pikërisht statistikat otomane të lidhura me qytetin e Janinës, me rrethet e Malakashit dhe çarkovistës. Për sa i përket rrethit të Kurendës (të shihet fleta e bashkëngjitur e veçuar N. 3)

Profesori grek Aravantinos që shkroi “Kronologjinë e Epirit” mbledhi, nga ana e vet, më 1856, të dhëna statistike mbi popullsitë e Malakashit dhe çarkovistës (Fletë të bashkëngjitura Nr.4 e Nr.5).

Rrjedh s’andejmi që për dy rrethet e përmendura ka statistika të dyfishta njëra (fleta e bashkëngjitur Nr.2) me burim otoman, tjetra (fletët e bashkëngjitura Nr.4 dhe Nr.5) me burim grek.

Midis tyre hyn një periudhë kohe prej 39 vitesh. Më duket e dobishme të shqyrtojmë veç e veç tabelat statistike otomane dhe ato greke.

Nga të parat del që në vitin 1895 popullsia e Janinës (qytet) të rrethit omonim dhe të rretheve të Malakashit dhe çarkovicës numëronte banorë 50.937 nga të cilat 26.779 meshkuj, 24158 femra, banues në 141 fshatra (në këtë numër përfshihet edhe qyteti i Janinës) të përbërë nga 9.713 shtëpi.

Sipas statistikave të Aravantinosit (fletë të bashkëngjitura Nr.4 dhe 5) në rrethin e Malakashit banonin më 1856, 1490 familje kryesisht të krishtera që, të llogaritura me 5 anëtarë për familje – mesatare normale - do të jepnin një numër prej gati 7500 banorësh. Në rrethin e çarkovistës banonin përkundrazi 797 familje – kryesisht të krishtera – që u përgjigjeshin rreth 4000 vetave.

Sipas profesorit Aravantinos, gjuha e folur në rrethin e Malakashit ishte atëherë (dhe është edhe tani) kryesisht greqishtja. Në 33 fshatra të rrethit të çarkovistës flitej përkundrazi në mënyrë të përzier greqishtja dhe shqipja.

Në fakt edhe tani në shumë fshatra të Çarkovistës dhe sidomos në ato që janë në kufi me çamërinë, bashkë me greqishten flitet gjuha shqipe.

Propaganda helene, këmbëngulëse dhe depërtuese, natyrisht ka synuar të zhdukë përdorimin e shqipes në pjesën më të madhe të 33 fshatrave të lartpërmendura, po e ka arritur këtë vetëm pjesërisht.

Po citoj emrat e fshatrave të përfshira në rrethin e çarkovistës që janë në kufi me çamërinë dhe me territorin e Prevezës në të cilat flitet greqishtja dhe shqipja:

Koristiani - Kanellaki – Xharavina – Mahalos – Mushotica – Kukoleshi – Nashari - Papadates - Melana – Shiada – Gjonalla – Xhermi - Gorena – Rushat – Bulmeti – Nikolici – Dara - Ano dhe Katokocanopoli – Ano dhe Kato Kravari – Buldari – Topillo – Vlado – Mujaka. Shumë nga këto fshatra janë vendosur pranë Panariotikosit që do të ishte i përshtatshëm me lumin Lakiotikos, për të formuar vijën e kufirit jugor me pushtimet e reja italiane në Epirin grek.

Duke iu kthyer statistikave të cituara nga shqyrtimi i tyre del që numri i banorëve të rretheve të Janinës – Malakashit dhe çarkovicës ishte më 1895, 50937.

Regjistrimi i Bashkisë së Janinës që bazohet mbi të dhëna të mbledhura nga autoritetet qeveritare helene në vitet 1913-1914 na jep përkundrazi shifrat që pasojnë dhe kanë qenë përmendur që në fillim:

Janinë (qytet) banorë	19.974
Malakashi banorë	20.478
Çarkovicë banorë	14.823
Tërësia	55.275

Pra, në rrethet e lartpërmendura, në krahasim me statistikën otomane të vitit 1895 domethënë në largësinë e 18 vjetëve është vërtetuar një shtesë popullsie prej 4.338 banorësh.

Sipas së njëjtës statistikë otomane, banorët e rrethit të Kurendës (fletë e bashkëngjitur N.3) ishin më 1895 13.493 banues në 41 fshatra, të përbëra prej 2302 shtëpive.

Statistika e vonshme greke (të shihet f.2) jep përkundrazi për po atë rreth të Kurendës 26.610 banorë me një shtesë popullsie në 18 vjetët e ndërmjetme, prej 13.117 individësh.

Duke përmbledhur, popullsia tërësore e Janinës (qytet) e rrethit omonim, Malakashit, çarkovistës, Kurendës, ishte më 1895 statistikë otomane - 64.430 banorë të ndarë në 182 fshatra të përbëra nga 7.015 shtëpi.

Në vitin 1913 – 1914 popullsia e po ato rretheve – statistikë greke - ishte përkundrazi 81.885 banorë, po kishte një shtesë 17.455 shpirtra.

Po përmend tani krahinat vllahe të Zagorisë dhe të Pindit.

Fleta e bashkëngjitur n.6 përmban statistikën e fshatrave dhe popullsisë vllahe të Zagorisë të nxjerrë prej të dhënave të botuara në vjetarin e Perandorisë Otomane të vitit 1895. Sipas këtyre të dhënave, numri i banorëve vllahe të Zagorisë është 23.941 nga të cilët 11,659 meshkuj dhe 12.283 femra të ndarë në 48 fshatra të përbëra nga 5390 shtëpi.

Qeveria greke ka mbledhur për llogari të vet një statistikë tjetër të fshatrave vllahofone të Zagorisë dhe Pindit të të reduktuar nga 48 (gjersa kjo i leverdiste nga pikëpamja politike) në 30 (le të shihet fleta e bashkëngjitur n.7).

Popullsia e 30 fshatrave të lartpërmendura është ndarë kështu nga autoritetet helene: 25.229 të greqizuar dhe 1.182 të rumanizuar. Këto shifra nuk e pasqyrojnë absolutisht të vërtetën, janë kompiluar vetëm në interesin helen.

Për të përcaktuar mjaft qartë karakterin rumun të Pindit dhe të Zagorisë vë re se vllahishtja është gjuha që flitet ekskluzivisht në fshatrat e po atyre krahinave që pasojnë:

Breasa 200 familje	Paleohori 40
Armata 70 familje	Dobrinovo 150
Paci (Pades) 200 “	Leashnica 250
Palevski 230 “	Perivoli 400
Greveniti 250 “	Abela 350
Çerneshi (shesh) 150	Smiksi 200

Flambulari (Floro) 80	Krania (Turia) 250
Makrini 40	Paltem 60
Vjosa (Bajosa) 100	Veloni 40
Samarina 700	Labenica 50
Laka (Laista) 360	

Shuma e tërë 21 fshatra 4.170 familje

4170 familjet e numëruara sipas një mesatareje të 5 anëtarëve secila japin një shumë tërësore prej 20.850 banorësh që duhet të quhen si vllahë të kulluar.

Meqenëse statistika që përmbahet në fletën e bashkëngjitur nr.6 jep një shumë tërësore prej 48 fshatrash për Zagorinë, s'andejmi rrjedh që si rezultojnë në fakt në 27 fshatrat që mbeten përveç vllahishtes flitet edhe gjuha greke sidomos nga të rinjtë që kanë frekuentuar shkolla greke dhe kanë ndjerë ndikimin e propagandës helene që i cilëson si "grekomanë".

Karakter kryesisht vllahë zotëron edhe qyteti i vogël i Mecovës dhe rrethi i bashkëngjitur. Ky territor i vendosur në anën jugore të Zagorisë formonte në kohën e sundimit turk një kaza i përfshirë në sanxhakun e Janinës dhe, nën sundimin helen, një nënprefekturë që varet njësoj nga Janina.

Për Mecovën (si për rrethet) e Malakashit dhe çarkovicës kemi një statistikë të dyfishtë (të shihet fleta e bashkëngjitur Nr.8). E para është nxjerrë nga të dhënat e mbledhura më 1856 nga profesori grek Aravantinos. Sipas asaj statistike në kazanë e Mecovës përfshiheshin katër fshatra - Votonosi – Malasi – Kutofliani – Milia (Aner).

Popullsia e po këtyre fshatrave (duke përfshirë edhe Mecovën) numëronte më 1856, 1.164 familje kryesisht të krishtera që me 5 anëtarë secila japin në tërësi 5.820 banorë. Në aspektin fetar rrethi i Mecovës, atëherë si tani, varet dhe varet drejtpërdrejtë nga Patriarkata Ekumenike e Stambollit duke pasur në Mecovë një përfaqësues të vetin që emërtohet "hezark".

Vetë profesor Aravantinosi pranon që në rrethin e cituar flitej sa rumanishtja ashtu edhe greqishtja. Edhe sot dy gjuhët, me mbizotërimin megjithatë të vllahishtes, fliten nga ato popullsi.

Statistika otomane e 1895 jep për kazanë e Mecovës me fshatrat që janë bashkëngjitur një popullsi në tërësi prej 5.371 banorësh dhe 1.148 shtëpish. Duke iu shtuar 20.850 vllahëve të 21 fshatrave të cituar në f.8 rezultojnë tërësia e popullsisë thjesht vllahë të Zagorisë, Pindit dhe Mecovës numëron 26.221 shpirtra. Bashkëngjitet këtu një pasqyrë te f.8 bis e përpiluar nga prof. Çuli i shkollës rumune të Janinës.

Nga këto të dhëna rezultojnë që popullsia tërësore e Pindit dhe Zagorisë është 43.112 banorë nga të cilët 26.221 janë vllahë që flasin kryesisht vllahishten, ndërsa 16.891 që mbeten flasin greqisht dhe pjesërisht vllahishten.

Një dalje e natyrshme dhe e detyruar e luginës së Zagorisë në veri është territori i Konicës që emërtohet si kaza në epokën turke dhe si nënprefekturë nën sundimin grek.

Nga shqyrtimi i statistikës otomane të 1895-ës rezulton që në rrethin e Konicës banonin atëherë 17.185 banorë të ndarë në 36 fshatra (duke përfshirë Konicën) të formuar nga 3.115 shtëpi (Fletë e bashkëngjitur n.9)

Në kufi me Konicën është kazaja e Pogonit (Voshtinës) (fletë e bashkëngjitur N.10) e ngritur në rangun e nënprefekturës nën regjimin grek. Për atë rreth statistika otomane e përpiluar më 1895 jep një shumë tërësore prej 19.882 banorësh që banojnë në 38 fshatra (duke përfshirë Voshtinën) të formuar prej 2.988 shtëpish.

Në jugperëndim të rrethit të Pogonit mbi vijën e lumit Kalamas është vendosur kazaja e Filiatesit (Fletë e bashkëngjitur N.11) për të cilën statistika turke e 1895-ës jep një popullsi prej 23.291 banorësh të ndarë në 67 fshatra (duke përfshirë Filiatesin) të përbërë prej 4.784 shtëpish.

Për sa i përket ndarjes së banorëve të rrethit të cituar më lart, sipas kombësisë dhe fesë, le të shihet pasqyra në faqen 3.

Shumica më e madhe e popullsisë në fjalë është shqiptare dhe flet gati ekskluzivisht gjuhën shqipe. Në shumë fshatra nuk njihet fare greqishtja.

Siç dihet kazaja e Filiatesit që nën regjimin grek ishte ngritur në rangun e nënprefekturës formon pjesën veriore të çamërisë.

Në kufi më të afërt në jug me krahinën e lartpërmendur është kazaja (që është gjithashtu nënprefekturë greke) e Paramitiasë (Aidonatit), të shihet fleta e bashkëngjitur n.12.

Statistika turke e 1895-ës jep lidhur me po këtë kaza që formon pjesën qendrore të çamërisë, shifrat e mëposhtme: 14.474 banorë: 65 fshatra (duke përfshirë Paramitianë): 2.661 shtëpi.

Përsa i përket ndarjes në kombësi e fe le të shihet pasqyra në faqen 3 nga e cila del që shumica e popullsisë është shqiptare dhe që gjuha e folur, me pak përjashtime, është shqipja.

Pjesa jugore e çamërisë përbëhet nga kazaja (nënprefekturë greke) e Margaritit për të cilin statistika e lartpërmendur turke e 1895-ës jep të dhënat që pasojnë (të shihet fleta e bashkëngjitur n.13): 23.955 banorë: 74 fshatra (duke përfshirë Margaritin): 5.224 shtëpi.

Mbi 23.955 banorë rreth 16.000 janë kryesisht myslimanë – shqiptarë (le të shihet pasqyra n. f. 3). Gjuha e folur në po këtë kaza është gati përgjithësisht shqipja. Në shumicën e fshatrave greqishtja nuk njihet. Fakti që kazaja e Margaritit ka një fizionomi të tillë etnike (75% e popullsisë është shqiptaromyslimane) është një rrethanë e favorshme meqenëse - duke pasur parasysh pozitën e saj gjeografike në lidhje me pjesën tjetër të çamërisë - në Konferencën e Paqes nëse do të respektohet zbatimi i parimit të kombësisë, kjo

do të çojë në mënyrë të domosdoshme në përfshirjen e tërë çamërisë Qendrore (Paramitia), veriore (Filatesi) dhe jugore (Margariti) në Shqipëri.

Në fakt s'do të jetë e mundur të përfshihet gjeografikisht rrethi i Margaritit në shtetin shqiptar pa përfshirë edhe dy të tjerët e lartpërmendur të Paramitiasë dhe të Filiatesit, të dy thjesht shqiptarë, po në të cilët ekziston gjithnjë një element ortodoks që – ndonëse etnikisht shqiptar – do të mund të cilësohet nga Greqia dhe nga fuqitë që do ta mbështesin në Kongres – si i greqizuar.

Sundimi helen - që ka zgjatur 4 vjet, domethënë nga 1913 deri në gjysmën e 1917-ës, për fat të mirë s'ka arritur ta ndryshojë në mënyrë të ndjeshme karakterin etnik të çamërisë që ka mbetur në pjesën më të madhe, shqiptar.

Janë vërtetuar nisje të familjeve myslimane të asaj krahine për në Stamboll dhe në Azi të Vogël.

Qeveria otomane nëpërmjet konsullatës së vet në Janinë, u dha mjetet e udhëtimit këtyre familjeve, numri i të cilave megjithatë mbeti i kufizuar. Ka qenë gjithashtu një rrethanë e favorshme fakti që çamëria u ka shpëtuar tmerreve dhe mizorive që kanë bërë grekët në Epirin e Veriut, sidomos në Kurvelesh, Leskovik dhe Kolonjë që patën si pasojë popullimin e asaj krahine dhe pakësuan elementin mysliman, që është ende mbizotërues, po sigurisht ka qenë në numër më të madh më 1912 se sa tani.

Më duket tani e dobishme të rimarr këtu dhe të përmbledh të dhënat e përmbajtura në statistikën e konsullatës austro-hungareze të janinës që jepet në f.2.

Nga shqyrtimi i tyre rezulton që shqiptarët e Filiatesit Paramitia – Margaritit janë gjithsej 54430 nga të cilët 33.330 myslimanë, 21.100 ortodoksë që flasin të gjithë gjuhën shqipe.

Grekët ortodoksë përkundrazi janë gjithsej 11.200 përbëjnë pra, vetëm të pestën pjesë të popullsisë dhe flasin edhe ata shqip.

Kjo është aq e vërtetë sa edhe në fshatrat e krishterë të çarkovistës (prefektura e Janinës) në kufi me çamërinë, flitet shqip (le të shihet f.5). Këto rrethana tepër të rëndësishme do të mund të përbëjnë në Kongresin e Paqes argumentet më të efektshme dhe më të padiskutueshme për të treguar si, duke zbatuar parimin e kombësisë, çamëria s'do të mund më të bashkohet me Greqinë, po duhet të përfshihet në Shqipëri ose sidoqoftë të gëzojë një regjim të veçantë.

Duhet t'u shtohet rrethanave të sipërcituara edhe urrejtja e thellë e elementit mysliman kundër sundimit grek që ka ushtruar në dëm të atij vetë një seri të gjatë mujshish, veprimesh arbitrare dhe të dhunshme.

Duke qenë të lirë nga shtrëngime dhe frikë nga reprezaljet, banorët myslimanë të Çamërisë, po të pyeten në kohën që zgjat pushtimi ushtarak italian, do të bëjnë të njihen, me votim të përgjithshëm, dëshirat e tyre për rendin e ardhshëm politik të çamërisë. Dhe mund të besohet si absolutisht e

sigurtë se kurrë ata s'do të mendojnë për të kërkuar të bashkohen prapë me Greqinë, ide kjo që i tmerron.

Italia, duke pushtuar vendin e tyre, ka marrë përsipër një detyrë të rëndë morale për t'i ndihmuar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre etnike, gjuhësore dhe kombëtare si edhe sigurinë e tyre personale, në Kongresin e Paqes.

Duke vazhduar shqyrtimin e statistikës së Konsullatës austro-hungareze të Janinës dhe me referim ndaj kazasë të Pogonit rezulton se 21.900 banorët e atij rrethi ndahen kështu: 3.000 shqiptarë nga të cilët 1.000 myslimanë dhe 2.000 ortodoksë – 16.000 grekë ortodoksë – 2.500 vllahë dhe 400 ciganë.

Gjuha e folur në Pogoni është greqishtja dhe ndjenjat e shumicës së popullsisë në përgjithësi janë progreke. Duket se pikërisht për këto shkaqe, kazaja e Pogonit, në përcaktimin e kufirit greko-shqiptar dhe në Konferencën e Londrës së 1914-ës nuk është përfshirë në Shqipëri.

Megjithatë duhet të vihet re se meqenëse krahina e Pogonit përshkohet në pjesën e saj veriore nga rruga Sarandë-Korçë, për shkaqet me natyrë politiko-ushtarake të parashtruara prej meje në telegramin nr. 63 të 6 prillit të shkuar, do të ishte e domosdoshme të përfshihej në territorin shqiptar rruga e lartpërmendur dhe domosdoshmërisht pjesa veriore e kazasë së Pogonit në mënyrë që të garantohej siguria ushtarake e arteries rrugore të cituar.

Sipas po asaj tabele statistike (fleta e bashkangjitur nr.1) kazaja e Konicës ka një popullsi tërësore prej 18.000 banorësh e ndarë kështu: 1.200 shqiptarë myslimanë – 12.600 grekë ortodoksë – 4.000 vllahë – 200 ciganë.

Shumica e popullsisë është, pra, greke –ortodokse dhe gjuha e folur në përgjithësi është pa dyshim, greqishtja. Ndjenjat e popullsisë, pa dyshim janë orientuar nga Athina. Po ka shumë rëndësi fakti që në rrethin e Konicës banojnë 4.000 vllahë. Është pra fjala që fshatrat vllahë të Paleoselit, Pardesit, Armatës dhe Breases, të vendosura në krahinën vllahë të Zagorisë.

Fshatrat e lartpërmendura kanë tregun e vet të natyrshëm në Konicë dhe në fakt përfshiheshin në rrethin administrativ të asaj qendre. Meqenëse Konicë pastaj është dalja veriore e tërë luginës së Zagorisë është e qartë që, në rast se në Konferencën e Paqes do të trajtohet dhe do të zgjidhet në mënyrë të favorshme çështja e “krahinës rumune të Pindit” pjesën më të madhe të së cilës e përbën Zagoria, do të përfshihet pa tjetër Konicë në Shqipëri.

Mendoj se tani do të paraqiste një farë interesi të parashtrohet ndonjë e dhënë dhe mendim mbi krahinën saktësisht të quajtur të Janinës.

Më 1903 (fletë e bashkëngjitur n.1) në kazanë e Janinës ekzistonin 450 shqiptarë myslimanë, 800 shqiptarë ortodoksë, 77.700 grekë ortodoksë 6.400 vllahë, 1.000 ciganë, 3.600 izraelitë.

Në statistikën e lartpërmendur të konsullatës austro-hungareze të këtij qyteti përfshihen 6000 myslimanë të quajtur si grekë myslimanë, çka që me gjasë do të thotë se në konceptin e atij që e përpiloi .... 6000 myslimanë

quheshin si me origjinë greke. Në tërësi shifrat e lartpërmendura japin një popullsi prej 95,950 banorësh.

Të dhënat e cituara megjithatë kanë pasur variacione. Bie fjala, myslimanët banues në qytet, sipas po asaj statistike të përpiluar nga myftiu i Janinës, arrijnë në 1703 ndërsa mund të mendohet se 6000 myslimanët e statistikës austro-hungareze nuk ekzistojnë më në vend, gjersa në fakt rezulton që pas pushtimit helen të qytetit rreth 5000 myslimanë kanë emigruar dhe kjo është aq e vërtetë sa ligjet turke të fortesës së Lucës, Mird-u-shad kanë mbetur të çpopulluara dhe një shumicë e madhe shtëpish myslimane edhe sot janë bosh dhe të mbyllura.

Si u tha edhe më lart, statistika greke e 1913-14 (shih f.6) jep për Janinën dhe për rrethet e Malakashit dhe çarkovicës 55.275 banorë. Duke hequr nga kjo shifër 6.400 vllahë (statistikë e bashkangjitur nr.1) dhe 1.703 myslimanë rezulton që kusuri, domethënë 47.172 banorë, janë grekë –ortodoksë.

Fizionomia etnike e rrethit të Janinës përcaktohet kështu qartë në drejtim helen (85%).

Raca së cilës i përkasin banorët e kësaj zone ngatërrohet në kohë me atë pelazgjike. Më vonë pati mbishkrime thrako-ilirike, sllave, po gjurma e lënë nga kalimi dhe banimi i fiseve helene shumë të lashta u ruajt nëpër shekuj.

Për të dhënë një ide për kohën e largët me të cilën lidhet fizionomi greke e këtij vendi (flas gjithmonë lidhur me rrethin e Janinës) do të citoj faktin që në mitologjinë greke Fushat e Elizit dhe hyrja e Ferit janë vendosur në afërsitë e Janinës. Lumi Aheron i legjendës s'është veçse Fanariotikosi që rrjedh në krahinën jugë-perëndim të Janinës dhe del në det në jugë të Pargës.

Orakulli i Didonës, që bashkë me atë të Delfit, numërohej ndër më të famshit e antikitetit helen, gjendet në Epir rreth 20 km në jug të Janinës. Aty u dhanë shfaqjet e para të dramave të Sofokliut dhe të Eskilit në gjuhën greke, gjuhë që pa dyshim ishte ajo që flitej në atë kohë në këtë zonë.

Është ruajtur ende mirë amfiteatri që shërbente për këto shfaqje, ndërsa nga tempulli i orakullit mbeten pak gërmadha pa formë. Shqiponjat e Romës që kanë pasuar mbretërinë e himnizuar të Pirros janë shpalosur gjatë edhe në Epir, po sundimi romak, duke lejuar autonominë lokale, nuk e çnatyroi karakterin e këtij vendi që mbeti grek në thelb.

Forcat e helenizmit, e racës, e gjuhës dhe të fesë kanë përshkruar gati pa u prekur - pesë shekujt e sundimit otoman.

Helenizmi i ndihmuar fuqishëm nga një propagandë e stërmadhe dhe pa skrupuj – ka pasur forcën që të asimilojë nga pikëpamja gjuhësore edhe familje myslimane të Janinës të cilat flasin si gjuhë të zakonshme greqishten ndonëse njohin edhe shqipen.

Në fshatrat e Malakashit dhe në shumicën e atyre të çarkovicës nuk flitet veçse greqisht. Ndjenjat e masës së madhe të popullsisë së Janinës dhe rrethit omonim (e kam fjalën për ortodoksët) s'janë fare shqiptare, përkundrazi - siç

kam mundur të konstatoj në 4 vitet e qëndrimit tim këtu - të krishterët e urrejnë Shqipërinë dhe gjithçka është shqiptare se kjo u kujton atyre pesë shekujt e skllavërisë së kaluar nën gjysmë-hënë.

Myslimanizëm dhe Shqipëri për masën e madhe të popullsisë së krishterë të rrethit të Janinës kanë të njëjtën vlerë dhe të njëjtin kuptim.

Megjithatë është fakt dhe e kam sinjalizuar disa herë se mënyra e gabuare qeverisjes greke ka krijuar zhgënjime të thella dhe ka larguar simpatitë e shtresave të varfëra nga qeveria e Athinës.

Sidoqoftë nga kjo që thamë më lart, rrjedh se popullsisë së rrethit të Janinës do t'u jepet një regjim qeverisjeje të bazuar në kritere shumë të ndryshme nga ato që ndiqen dhe do të mund të ndiqen në krahinat e Gjirokastrës, Çamërisë, Zagorisë dhe Pindit ku përkatësisht mbizotërojnë shqiptarët dhe kuco-vllehët mbi grekët ortodoksë.

Do të mbahen pra parasysh shkaqet etnike gjuhësore dhe ndjenjat e popullsisë kundër Shqipërisë për të përcaktuar një sjellje dhe një veprim qeverie të tillë që do ta pajtojë respektin ndaj këtyre ndjenjave me interesat tona dhe me ato të Shqipërisë. Aty ku të jetë e mundur pa i prekur interesat italiane, do të kënaqet elementi grek ortodoks i ish-prefekturës së Janinës. Ky element i pajisur me një mençuri të mprehtë, duket më i përshtatshëm nga atavizmi dhe karakteri të na ndjekë në veprën e qytetërimit të vendit se sa elementi mysliman, i penguar në lëvizjet e veta drejt përparimit nga feja myslimane në të cilën gati është kristalizuar. Drejtësia dhe paanësia duhet të jenë absolute për dy elementët e lartpërmendur.

Në administratat publike duhen llogaritur të drejtat e shumicës greko-ortodokse (dhe, me mprehtësi autoritetet tona ushtarake e kanë kuptuar këtë mundësi dhe, lidhur me këtë, kanë marrë masa) duke i dhënë kësaj shumice vendin që i takon duke pranuar kuptohet të përfaqësuesit e myslimanëve aty ku ata ekzistojnë, qofshin edhe në pakicë.

Në veçanti feja ortodokse duhet mbrojtur në mënyrë të efektshme nga autoritetet italiane. Çështja e klerit ortodoks – organizimit të të cilit shumë urtësisht s'do t'i bënin modifikime ka një rëndësi jetësore dhe me të, për mendimin tim është lidhur ngushtësisht mbarëvajtja dhe rezultatet e goditura që mund të nxirren nga pushtimi ynë.

Dihet çfarë ndikimi ka kleri ortodoks mbi shpirtin tepër fetar, veçanërisht të fshatarëve epirotë.

Meqenëse me të drejtë mendohet se të gjitha të ardhurat e vendit do të përdoren në dobi të këtyre popullsive një nga veprimet e para të qeverisjes sonë – veçanërisht me vend dhe me kuptim politik – do të jetë të shtohen në mënyrë të ndjeshme dhe në përpjesëtim të drejtë rrogat e klerit të lartë dhe të ulët ortodoks, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë, gjendjen shumë të trishtuar ekonomike në të cilën jetojnë tani priftërinjtë e fshatit, gjendje që

rëndohet nga fakti që gati të gjithë, meqenëse u lejohet martesë, kanë në ngarkim familje të mëdha.

Në këtë mënyrë dhe duke treguar një farë kujdesi ndaj krerëve fetarë, do ta kemi të mundur të fitojmë simpatinë e klerit dhe do të mund të themi atëherë se kemi kryer një hap të ndjeshëm përpara për të popullarizuar pushtimin tonë dhe regjimin që po inaugurojmë.

Çështja e shkollave paraqitet gjithashtu e rëndësishme.

Me të drejtë është vendosur që shkollat greke në Janinë dhe në territoret e pushtuara tani vonë të ruhen. Rrogat e mësuesve megjithatë duhet të shtohen duke përdorur për atë qëllim një pjesë të të ardhurave të vendit që qeveria e Athinës ia hiqte krejt vendit pa dhënë asgjë në shkëmbim, fakt që përcaktoi pakënaqësinë e rëndë për të cilën kam folur më parë.

Gjimnazi – lice i Janinës do të duhet të ruhet ashtu s'është me personelin arsimor që përmban.

Për të dhënë një ide për rëndësinë e Institutit të lartpërmendur, do të mjaftojë të thuhet se tetë kurset në të cilët ndahet (4 të gjimnazit dhe 4 të liceut) frekuentohen nga rreth 600 studentë që u përkasin të gjitha kohërave të Epirit dhe të Shqipërisë së jugut si Përmeti, Delvina, Gjirokastra, Leskoviku, Erseka. Ka edhe studentë nga Berati. Natyrisht asnjë i ri mysliman nuk frekuenton të lartpërmendurin gjimnaz-lice që emërtohet sipas emrit të themeluesit Mikel Zosima.

Epirotë të pasur që kanë qëndruar jashtë shtetit dhe kanë fituar pasuri të konsiderueshme (Averofi, bie fjala, është një vllah i Mecovës) kur vdiqën, lanë trashëgimi të mëdha për Institutet e bamirësisë dhe të edukimit të Epirit.

Të ardhurat e këtyre trashëgimeve në vit arrijnë në 200.000 drahmitë vetëm për qytetin e Janinës.

Në kohën e pushtimit turk ishte bashkësia ortodokse qytetare që i administronte kapitalet (të përbëra nga depozita të mëdha në flori pranë Bankës Kombëtare të Greqisë në Athinë) që japin të ardhurat e përmendura. Qeveria greke duke pasur atë otomane kërkoi për vetë administrimin e trashëgimive për sa i përket kuotës që u takonte shkollave: ndërsa përkundrazi për ato që u takon Instituteve të bamirësisë ekziston një komision i kryesuar nga Metropoli.

Detyrat në komision janë me zgjedhje.

Duke përfituar nga situata aktuale - qoftë a jo pushtimi ynë përfundimtar - për mendimin tim do të ishte me vend ta bëje të detyrueshme në shkollat greke të Janinës të çfarëdo shkalle gjithashtu në ato të rrethit omonim - mësimin e gjuhës italishte.

Lidhur me këtë vë re që në Gjimnazin – Lice të Janinës frëngjishtja është e detyrueshme. Ky rast i mëparshëm për ligj mësimin në po këtë Institut edhe të italishtes.

Po që se më vonë do t'ia kthejmë vendin Greqisë do të jetë fitim për ne se kemi përhapur njohjen e gjuhës sonë në Epir. Një konvencion i veçantë midis

Italisë dhe Greqisë do të mund të vendosej për të njohur si të detyrueshëm të mësuarit e italishtes në Gjimnazin – Lice të Janinës – në mos në të gjitha shkollat e ciklit të ulët – në mënyrë reciproke të pranimit të mësuarit të greqishtes së vjetër të dhënë në gjimnazet dhe licetë italiane.

Njohja e gjuhës sonë do të mund të krijojë një rrymë intelektuale midis Italisë dhe Greqisë që do të jetë në avantazh të dy vendeve të destinuara për pozitën gjeografike përkatëse të kenë marrëdhënie të ngushta politiko-tregtare.

Do të ishte me dobi të ushtroje një veprim kontrolli mbi Gjimnazin – Lice të Janinës. Përbri Drejtorit të Institutit të cituar – Jorgo Kaludisit, njeri i qetë dhe i ndershëm ndonëse ushqen ndjenja venizeliste – mund të vihej një delegat i yni i ngarkuar të mbikëqyrë mbarëvajtjen e shkollave të tërë rrethit dhe të vigjëllohej që të lartpërmendurat shkolla të mos kthehen në vatra propagande kombëtare helene dhe armiqësore ndaj pushtimit italian.

Për një detyrë të tillë do të duhej një person i përshtatshëm i zgjedhur nga Ministria e Arsimit Publik, që të njohë mirë frëngjishten dhe që të mbështetet nga një përkthyes i mirë.

Një masë paraprake e menjëhershme që duhet marrë ndërkaq, gjatë periudhës aktuale të pushimeve verore, do të ishte ajo për të shtuar ndieshëm rrogat e mësuesve të shkollave të ciklit të ulët dhe profesorët e këtij Gjimnazi – Lice.

Edhe këtu gjendja ekonomike e mësuesve s'është aspak e kënaqshme dhe ka qenë acaruar nga gjendja e luftës që natyrisht rëndoi shumë mbi ekonominë e përgjithshme në Epir.

Ngritja e rrogave me siguri do të kishte si pasojë që t'i bënin më të favorshëm ndaj nesh o të paktën më pak armiqësorë mësuesit që kanë pikërisht si mision që t'u frymëzojnë të rinjve ndjenja kombëtare helene.

Mjetet financiare për realizimin e kësaj mase do të mund t'i jepte vetë vendi, të ardhurat e të cilat duhet të përdoren ekskluzivisht për përmirësimin ekonomik të popullsisë dhe nevojat e vetë kësaj popullsie.

Natyrisht s'do të lihet pas dore çështja e rëndësishme e shkollave në krahinat vllahe të Zagorisë dhe të Pindit. Për mendimin tim, aty do të arrihej në zhdukjen graduale të shkollave greke duke ruajtur dhe duke shtuar përkundrazi numrin e atyre rumunëve. Elementi grekoman, mbi të cilin ushtrohen propaganda dhe fuqia tërheqëse greke, po tyë zhduken shkollat helene, do të duhej t'u drejtohej atyre rumuneve dhe së fundi, do të shkrihej me elementin vllah që përbën pikëmbështetjen e pushtimit tonë në Zagori dhe në Pind dhe pionierin e përhapjes politiko-tregtare italiane në Maqedonil. Mendoj se ka interes të bashkohet statistika (fletë e bashkëngjitur n.14) e shkollave rumune të Zagorisë dhe të Pindit që varen drejtpërdrejtë nga konsullata e Rumanisë në Janinë që për mbajtjen e po këtyre shkollave (duke përfshirë ato filllore e tregtare të Janinës) dhe për rrogat e mësuesve përkatës shpenzon në vit shumën e gati 100.000 frangave të paguara nga Ministria e Punëve të jashtme Rumune.

Nga pasqyra e lartpërmendur del që numri i po këtyre shkollave është 22 me 600 nxënës të të dy gjinive dhe me 45 mësues e profesorë. Do të ishte me vend që t'i jepej çdo lehtësim funksionimit të shkollave rumune duke shtuar numrin e tyre dhe duke marrë pjesë në shpenzimet që do të sjellin ato.

Si për mësuesit grekë, do të duhej të shtoheshin rrogat edhe të mësuesve rumunë të fshatit që marrin sot paga qesharake që ndryshojnë nga 80 deri në 120 franga në muaj. Gjithashtu do të duhej të tregohej kujdes dhe lehtësim për konsullatën e Rumanisë në Janinë të drejtuar nga zoti Minku, person miqësor ndaj nesh të cilit do të ishte rasti t'i jepej një dekoratë.

Politika e qeverisë rumune dhe, si rrjedhim, ajo që zhvillon konsullata e saj në Janinë, ka të njëjtat qëllime që ka qeveria jonë domethënë të shkëpusë nga Greqia elementin vllah të Zagorisë dhe të Pindit që, me një proces të vazhdueshëm çkombëtarizimi dhe madje me mjete të dhunshme (bie fjala me veprim bandash) qeveria e Athinës është përpjekur vazhdimisht që ta zhdukë.

Mbi vllahët e Zagorisë dhe të Pindit ne mund të mbështetemi me siguri. Është fjala për popullsi sinqerisht besnike ndaj nesh, që simpatizojnë për Italinë që kanë parë te ushtarët tanë çlirimtarët e vet nga zgjedha helene dhe nga fati i trishtuar që i priste nën sundimin grek.

Me një politikë mirëdashëse dhe të drejtë dhe me pak përpjekje mund ta bëjmë të patundur afeksionin e vllahëve ndaj çështjes italiane dhe Italisë.

Shumë "grekomanë" që mendohej se do të ishin përfundimisht të humbur për çështjen rumune po vinë tek ne spontanisht dhe tek ata zgjohet ndjenja instiktive e racës që e kanë të përbashkët me ne dhe që vepron si levë e fuqishme për afrimin me Italinë.

Propaganda greke, nëse u ka dhënë "grekomanëve" një cipë helenizmi nuk e ka prekur thellë dhe nuk e ka zhdukur ndjenjën e origjinës dhe ndjesinë e sigurt të orientimit ndaj interesave të tyre të vërteta.

Tani që janë realizuar shpresat vllahe ankthi me të cilin ato popullsi vështrohen drejt Italisë ia ka lënë vendin një ndjenje sigurie të qetë pas pushtimit italian.

Manifestimet që i pritën trupat italiane në fshatrat vllahë kanë qenë entuziaze. Popullsitë dolën të mallëngjyera për të pritur ushtarët tanë që i përqaftuan vëllazërisht. Kleri rumun himnizoi Italinë, Sovranin tonë August dhe ushtrinë trime.

Po sinjalizoj si karakteristik faktin se në Samarinë fshatarët vllahë që i kuptonin ushtarët tanë - meqenëse vllahishtja i ngjan italishtes - thoshnin se kishin gjetur përsëri vëllezërit e tyre.

Oficerët tanë që kanë ardhur në Janinë nga Zagoria dhe Pindi flasin të mallëngjyer për pritjen që kanë parë atyre trupat italiane. Në raportet dhe telegramet e mia unë kam bërë gjithnjë parashikime në këtë drejtim. Të tërhiqemi nga Zagoria dhe nga Pindi do të thoshte ta lemë në një fat edhe më të trishtuar se ai që rëndonte mbi ta, ato krahina tyë bukura dhe bujare.

Zemërimi grek i nxitur nga pritjet entuziazte dhe mallëngjyese që iu bënë trupave tona, do të ushtrohej në hakmarrje ndaj atyre popullsive që do të paguanin në mënyrën më të dhimbshme simpatinë dhe dashurinë që na kanë shfaqur.

E njëjta gjë do të mund të thuhet për banorët myslimanë të çamërisë (të shihet f. 11 dhe ato që pasojnë).

Në bazë të parimit të kombësisë që ajo do të kërkojë të zbatohet apo do të nxisë të tjerë të kërkojnë zbatimin e tij në Kongresin e Paqes, Greqia s'mund të këmbëngulë me themel se zotëron ndonjë të drejtë etniko-gjuhësore mbi Zagorinë, mbi Pindin dhe çamërinë. Të dhënat e përmbajtura në këtë raport argumentojnë në mënyrë shterruese mungesën e një të drejte të tillë në Greqi.

Popullsitë e tri krahinave të lartpërmendura po të lihen të lira të shprehin ndjenjat dhe aspiratat e veta (dhe kjo s'do të ndodhë kurrë po të bien përsëri nën zgjedhën helene që do të përdorë frikësimi dhe kërcënime) do t'u bëjnë të njohur Komisioneve të delegatëve të fuqive sot në luftë që do të mblidhen një ditë në Kongresin e Paqes, në rast se do të vendoset si do të qe me vend të dërgohen ato komisione për t'u njohur me karakterin etniko-gjuhësor të popullsive të përmendura, se cilat do të jenë dëshirat e tyre dhe domethënë kthimi nën sundimin grek apo bashkimi me Shqipërinë nën hijen e flamurit italian.

Jam në Janinë prej katër vjetëve dhe i njoh metodat greke për përvojë personale.

Për shembull i njoh të gjitha prapaskenat e komedisë së luajtur nga Qeveria Provizore e Epirit të Veriut e ndihmuar fshehurazi nga qeveria e Athinës. E di se si, me rastin e arritjes dhe qëndrimit të Komisionit Ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve epirote-shqiptare më 1913, vetë autoritetet qeveritare helene të Janinës dhe në veçanti i ndjeri Guvernator i Përgjithshëm, zoti Foresti, kanë inskenuar demonstrata të rreme helenizmi aty ku nuk ekzistonte as hija e helenizmit (bie fjala, Korça – Kolonja – Erseka – Gjirokastra).

Le t'u jepet liri popullsive për t'u prononcuar lirisht pa frikë reprezaljesh apo hakmarrjesh dhe do të shihet nëse çmimet e Kalamasit deri në Fanariotikos dhe vllahët nga Konica në Mecovë dhe në Samarinë – Grevenë do të zgjedhin Greqinë apo Italinë.

Tashmë vendi ynë s'do të mund të qëndrojë më indiferent ndaj fatit të atyre popullsive. Këtë gjë unë e pohoj ndërsa nga ana tjetër kam parashtruar shkoqur, se kjo është e vërteta, secili është karakteri etnik i krahinës së Janinës dhe çfarë prirjesh kanë banorët e saj duke e quajtur jo vetëm të dobishme, po edhe të domosdoshme që në Konferencën e Paqes, delegatët tanë duke e përballuar një lëndë të tillë delikate, të njohin dhe të jenë të informuar për situatën e saktë efektive të këtyre krahinave dhe të argumenteve që

kundërshtarët tanë do të mund të sjellin kundër interesave tona dhe për synimet e politikës së tyre.

Po të vijmë te argumenti i pushtimit ushtarak italian të Janinës dhe të territoreve të përfshira aty, mendoj se autoritetet ushtarake dhe qytetare italiane kanë një detyrë mjaft të rëndë dhe delikate.

Situata e krijuar këtu dhe e lënë nga regjimi grek është tepër e favorshme për ne: na takon neve ta shfrytëzojmë në interesin tonë dhe në atë të popullsisë vendase.

U duhet treguar atyre në mënyrë të qartë dhe të dukshme se sa më i lartë dhe i ndryshëm është në të gjitha shfaqjet e veta administrimi italian në krahasim me atë grek i cili gjatë katër vjetëve, s'bëri dot gjë tjetër veç t'i thithë gjakun vendit duke eksportuar nga Epiri dymbëdhjetë miliona franga, duke e bërë tepër të pështirë me taksa doganore dhe taksa të tjera të rënda jetesën e tërë shtresave të shoqërisë dhe duke mos dhënë asgjë si këmbim.

Drejhtësia, barazia në trajtim pa dallim individësh, klasash e feje, gjerësi në mjetet, shqetësimi për të plotësuar – në mënyrë të veçantë – nevojat e më të varfërve (çështja e furnizimit me ushqim është në vendin e parë dhe duhet të zgjidhet në mënyrë rrënjësore) do të na bëjnë të fitojmë vlerësimin dhe simpatinë edhe të asaj pjese të elementit greko-ortodoks që tani ngurron po do të përfundojë duke pranuar tërë rëndësinë e përfitimeve që do të sjellë administrimi mendjendritur dhe mirëdashës i një fuqie të madhe si Italia, drejtimi administrativ i së cilës dhe potencialiteti i mjeteve janë pafundësisht më të lartë se ato e një shteti të vogël si Greqia, ku pasionet partiake zvetënojnë ndjenjat më fisnike të patriotizmit, qytetërimit dhe altruizmit.

Një komunikim të njejtë, me po ato fletë të bashkangjitura, ia bëj Legatës Mbretërore në Athinë.

Me respekt të thellë

NUVOLARI

**Burimi:** *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918)*, Pacco 37 (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 1100955-1100982)

\*

\* \*

Konsullata e Përgjithshme e Italisë në Janinë

Janinë, 3 prill 1918

Nr.509/54

Objekt: Përjashtimi nga shërbimi ushtarak në Greqi i vorio-epirotëve

Zoti Ministër,

Fletë e bashkëngjitur nr.3

Shkëlqesisë së Tij

Konti De Bozdari  
Ministër Mbretëror i Italisë  
Athinë

Duke iu referuar raportit tim

N. 57/5 të 16 janarit kam nderin të informoj Shkëlqesinë Tuaj që ky Guvernator i Përgjithshëm si përgjigje e një letrës sime N.197 të 6 shkurtit të kaluar me të cilën kërkoja përjashtimin nga shërbimi ushtarak në Greqi të riut Dhimitër Kozma meqenëse e ka origjinën nga Labova, rrethi i Gjirokastrës më ka transmetuar komunikatën që jap të bashkangjitur këtu në kopje.

Nga komunikata në fjalë Shkëlqesia Juaj do të verë re:

1) që këto autoritete greke mbrojnë parimin se regjistrimi në regjistrat bazë është e vetmja bazë mbi të cilën mbështetet autoriteti ushtarak grek për shërbimin e rekrutimit.

2) që regjistrimet në këto regjistra mund, në fakt, të ndryshohen, po kjo s'mund të ndodhë veçse në bazë të procedimit të përshkruar nga ligji dhe në çdo rast, kurrë në epokë mobilizimi.

3) që autoritetet greke procedojnë zyrtarisht për përjashtimin e atyre që figurojnë në regjistrat bazë të territoreve të vendosura në veri të linjës së Firences.

Kjo do të thotë se autoritetet në fjalë zotërojnë regjistrat e popullsisë të qyteteve dhe fshatrave të Epirit të Epërm, regjistra që kanë marrë me vete në çastin e evakuimit të atij territori.

Si rrjedhim, përjashtimi nga shërbimi ushtarak i vori-epirotëve i lihet në dorë gjykimit arbitrar të autoriteteve ushtarake në fjalë të cilat mund të deklarojnë se individit filan apo aksh individit tjetër nuk figuron i regjistruar në regjistrat e Epirit të Epërm dhe prandaj s'ka të drejtë përjashtimi.

Për të ligjëruar këto dyshime mbi mirëbesimin e autoriteteve të lartpërmendura do të mjaftojë t'ju citoj faktin se jo më vonë se dje dy ushtarë të rinj ortodoksë, njeri nga Sotira, tjetri nga Sopiki (Gjirokastër) erdhën në konsullatë për të kërkuar përjashtimin e tyre, gjer tani jo të pranuar nga Komanda, që i sjell rrotull, herë me një pretekst, herë me një tjetër, dhe nuk po u jep fletën përkatëse të përjashtimit.

Lidhur me regjistrimin në regjistrat bazë mendoj se në fakt është e vërtetë që me deklarata publike të redaktuara nga kryepleqtë e fshatrave të cilave u përkasin vorio-epirotët në fjalë, mund të arrihej përjashtimi i tyre, megjithatë është e qartë se një procedim i tillë është i vështirë dhe i ndërlikuar dhe nuk i përgjigjet gjithnjë synimit që i vë vetes.

Duhet shtuar që edhe, duke paraqitur të tilla deklarata publike, ka të ngjarë që autoritetet greke s'do t'i kishin parasysh, meqenëse sipas mendimit të shprehur nga Ministri i Luftës në Athinë, asnjë ndryshim s'mund t'u bëhet regjistrave në kohë mobilizimi.

Vë re që sipas parimit të shënuar në notën e Stërgiadisit, mund të jenë tepër pak njerëzit me origjinë nga Epiri i Epërm banues në Greqi që të mos figurojnë të regjistruar në regjistrat bazë.

Pra, është e qartë që me rastin e regjistrimit, pagimit të taksave, redaktim të rolit të taksave, regjistrimesh, të bëra zyrtarisht nga organe bashkiake apo autoritete policore (si, bie fjala, regjistrimi për pjesëmarrje në racionim që zgjat nga koha e bllokut domethënë nga dhjetori 1916) duke proceduar për hedhjen në regjistra të popullsisë të gjithë të pranishmëve pjesëtarë të kombit a të huaj banues në Epir, pa dyshim janë përfshirë edhe ata me origjinë nga Epiri i Veriut.

Në një situatë të tillë urdhëri i Ministrisë Greke të Luftës me datë 17 tetor 1917 N. 98949 i konceptuar kështu: Po e bëjmë të njohur që ata me origjinë nga Epiri i Epërm *të cilët nuk janë regjistruar si nënshtetas në vise të tjera të Greqisë* nuk duhet të merren ushtarë dhe ata që janë rekrutuar dhe kryejnë shërbim menjëherë duhet të lirohen dhe të ardhmen duhet të kushtohet vëmendje në këtë drejtim . Ministri: Nënshkruar Mikalakopulos përfshin – duke lënë mënjanë përjashtime që vijnë nga harresa apo matura e ndonjë banori (sidomos bejlerë myslimanë) të Epirit të Epërm që ka bërë me kohë rezerva mbi origjinën e vet shqiptare – tërë vorio-epirotët e transferuar për arsye të ndryshme në vise të tjera të Greqisë.

Midis tyre përfshihen edhe ata që u transferuan në Epir për t'u shpëtuar persekutimeve të bëra kundër myslimanëve të Shqipërisë së Jugut gjatë periudhës së famshme autonome të Zagrofosit (të shihet letra ime N.443 të 21 marsit e drejtuar Stergiadisit për të cilën bashkëngjis një kopje).

Si rrjedhim, urdhëri i Ministrisë greke të luftës është plotësisht iluzor lidhur me përjashtimet për të cilat flitet dhe nuk u përgjigjet fare - në mënyrën e ngushtë me të cilën zbatohet aktualisht nga autoritetet ushtarake greke-synimeve të qeverisë Mbretërore në bazë të të cilave është kërkuar përjashtimi i vorio-epirotëve nga shërbimi ushtarak në Greqi.

Për atë çështje desha pikërisht të hedh fjalën në pjesën e fundit të raportit tim të cituar të 16 janarit të kaluar. Sa kohë që autoritetet helene zbatonin në mënyrë të arsyeshme urdhërin e përmendur – si dukej nga konteksti i këtij raportit tim – gjërat vazhdonin pa probleme dhe pa u lënë vend vërejtjeve të përligjura nga ana jonë, por kur, - si ndodhi tani - i jepet një interpretim aq i ngushtë urdhërit në fjalë, arrihet si rezultat që çdo përjashtim të vorio-epirotëve bëhet, si të thuash, gati i pamundur.

Lidhur me këtë interpretim citoj këtu rastin e parashtruar në fletën e bashkëngjitur N.2 lidhur me dy myslimanët me origjinë nga Përmeti (Shqipëri e Jugut) Hysni Abdullahu dhe Mynir Muharremi, të përjashtuar tashmë nga shërbimi ushtarak dhe të detyruar tani të paraqiten nën armë, rastin e Dhimitër Kozmës dhe atë të bijve të Fuad bej Frashërit banues në Filipjedes për të cilët kam mbrojtur parimin (le të shihet kopja e bashkëngjitur e letrës sime N.199 të

6 shkurtit të kaluar në Strigjadis) që s'janë të detyruar të ndjekin shërbimin ushtarak në Greqi se në bazë të artikullit 14 të ligjit grek TNA të 28 tetorit 1856 duhet të quhen si nënshtetas të huaj meqenëse kanë lindur nga baballarë të huaj.

Praktikat e bëra prej meje pranë këtij guvernatori të përgjithshëm për të arritur përjashtimin e të rinjve të përmendur më lart kanë mbetur krejtësisht të kota.

Shkëlqesia Juaj do të gjykojë po a do të jetë rasti për të ndërhyrë pranë Qeverisë së Athinës që të qartësohet apo tyë ndryshohet teksti i urdhërit të Ministrisë Greke, për të cilën flitet në mënyrë që premtimi dhe angazhimi i marrë nga Qeveria e Venizelosit për të përjashtuar nga shërbimi ushtarak vorio-epirotët banues në Greqi të mos jetë vetëm iluzor.

Shkëlqesia Juaj do ta shqyrtojë gjithashtu a do të jetë rasti që ta bëjmë të njohur që, në analizë të fundit, është fjala vetëm për pak raste të paraqitura gjer tani për të cilat protestohet (domethënë pesë rastet e përmendura tani, duke shtuar atë të shqiptarit Demir Kurti nga Frashëri banues në Konicë) dhe që për këtë arsye nuk do të dëmtohet aspak mobilizimi grek duke përjashtuar gjashtë të rinjtë vorio-epirotë të lartpërmendur.

I dërgoj një kopje të këtij raporti Ministrisë Mbretërore

Me respekt të thellë

Nënshkruar: NUVOLARI

**Burimi:** *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918)*, Pacco 37 (marrë nga *Arkivi i Institutit të Historisë*, img. 1110400-403)

Përktheu: **Klara KODRA**  
Përgatiti për botim: **Beqir META**